

## STRUCTURAL METHODS, GRAMMATICAL DISTRIBUTION AND ITS EFFECTIVENESS IN TEACHING OF THE FOREIGN LANGUAGE METODA STRUKTURALE, DISTRIBUIMI GRAMATIKOR DHE EFEKTSHMERIA E SAJ NE MESIMDHENJEN E GJUHES SE HUAJ

LENDITA GJIKOLLI, MIRLINDA SHEHU  
lenagjikolli@gmail.com

AKTET VI, 3: 185-189, 2013

### PËRMBLEDHJE

Zhvillimi i vrrullshëm i shkencave teknike mundësoi avancimin e metodave të mësuarit të gjuhës frënge, në përvetësimin, zbatimin e metodës strukturale në një anë, dhe në anë tjetër në motivimin e nxënësve për të mësuar strukturat globale gjuhësore, terminologjinë gjuhësore që japin mundësi të përdoren automatizma të nevojshme në praktikën e gjuhës së folur dhe asaj të shkruar. Përvetësimi i fjalëve dhe nocioneve gramatikore përmes metodës strukturale mundëson zotrim efektiv, që kërkojnë sot nevojat e komunikimit të përditshëm. Kjo metodologji mbështetet në parimin e ripërdorimit intensiv në kontekste të ndryshme të strukturave prandaj, edhe përparësia e kësaj metode është se u mundësohet nxënësve që përmes strukturave gramatikore të mësojnë më lehtë një gjuhë të huaj përmes distribuimit të njërive, automatizmave gjuhësore, të dëshifrojnë konstruktionet e memorizuara duke u mbështetur në sistemin e trajtave themelore, tingujve dhe të kontrasteve sipas strategjisë gjuhësore që shprehë kjo metodë.

**Fjalët çelës:** Fajlestruktura, motivimi, distribuimi, kontrastet, efektshmëria.

### SUMMARY

Rapid development of technical sciences enabled the advancement of the methods of teaching French language in acquiring, implementation of structural method on the one side, and on the other side to motivate students to learn global language structures, linguistic terminology used to provide opportunities automatism necessary to practice the spoken and written language. Acquisition of words and grammatical concepts through structural method which enables effective command that today require, daily communication needs, whether it be professional or scientific research. This methodology relies on the principle of reuse in different contexts intensive structures and therefore, the main advantage of this method is that it enables students to learn the grammatical structures through easier foreign language through the distribution of units, linguistic automatism, to decipher structure of memorized by system based on fundamental traits, sounds and contrasts the strategy language that expresses this method.

**Key words:** Structure, Motivation, Distribution, Contrasts, Effectiveness.

---

Strukturalistët e shekullit XX na bëjnë me dije se çdo gjuhë posedon organizimin specifik dhe dallohet nga të tjerat si në fjalët, format dhe vlerat e tyre, ashtu si dhe nga struktura sintaksore, ku integrohet për të formuluar formulime etj.

Strukturalistët përshkruajnë gjuhën e folur të një bashkësie aq sa është e dhënë e një

korpus regjistruar. Ata e zbatojnë në këto formulime të këtij korpusi një metodë pothuaj mekanike, duke shfrytëzuar kritere formale dhe distribucionale që mundëson segmentim të formulimeve në pjesë përbërëse që mund të klasifikohen. Kështu gjendet inventari dhe klasifikimi i strukturave gramatikore. Për strukturalistët, "gramatika nuk është më një tërësi

rregullash, por vetëm një listë e strukturave gramatikore”.

Sipas Eddy Rouletit mund t’i bashkojmë modelet e ndryshme të analizës nën etikën e gramatikës strukturale, gramatikës distribucionale, të gjitha këto përbëjnë variantet të të njëjtit model formal, e të cilat në vija të trasha, furnizojnë të njëjtën gjë, në mësimdhënien e gjuhëve të huaja. Njëri ndër nocionet më frytëdhënëse, që kërkimet gjuhësore ia kanë afruar metodologjisë së gjuhëve të huaja, është ai i strukturës si rregullim intern i njësive gjuhësore.

Pra, fillimisht duhet të precizohet nocioni i strukturës për gjuhësinë aplikative në mësimdhënien e gjuhëve të huaja.

Në gjuhësinë fundamentale struktura sintaksore është organizimi i përgjithshëm i të shprehurit gjuhësor duke u nisur nga funksionimi i njësive gjuhësore. Në gjuhësinë e aplikuar, struktura është një mënyrë zgjedhjeje dhe rregullimi fjalësh që implikojnë nga subjekti folës (sujet parlant) ose që shkruan një zakon të posaçëm a një mekanizëm inkoshient

Për Jean Guenotin struktura zë vend me rëndësi në analizë gjuhësore, mu për atë se gjuhëtarët në gjuhë kanë vërejtur sisteme simbolesh me vlera perceptuale. Duke filluar nga ideja e sistemit, organizimit, dispozitës dhe rregullimit, termi strukturë në gjuhësinë e aplikuar u begatua në drejtim të kuadrit që ngërthen trajta të montuara të fiksuara, me ç’rast vetëm ornamentet ndryshojnë. Elementet fikse marrin formë të rubrikave të njëpasnjëshme (të radhitura), ku çdonjëra mund të ketë një funksion të ndryshueshëm si nga natyra, ashtu edhe nga vendi.

a) Kështu, struktura bëhet zinxhir rubrikash, kurse ushtrimi struktural – fenomen dinamik për manifestim të radhitura të këtyre rubrikave.

b) Meqë është zbatuar në mësimdhënien e gjuhëve, gramatika strukturale paraqet përparësi të madhe sepse

c) – ajo përshkruan gjuhën në përdorim të një bashkësie, epoke, ajo përshkruan gjuhën e folur të cilën nxënësi ka nevojë ta ketë si mjet komunikimi,

d) –ajo propozon perkufizime të sakta precize dhe verifikuese bazuar në kritere formale dhe në kritere distribucionale, ajo paraqet njësi gjuhësore në konstruksione modele që ua mësojmë nxënësve këto rubrika zinxhirore

Psh Denise a acheté cette blouse hier

e) Nxënësit mund t’i ndërrojnë stukturat duke i zëvendësuar me elemente të reja, njërën me tjetrën. Shembujt që do t’i japim në vijim e përforcojnë të qenësishmen e kësaj metode Psh

Denise a acheté cette blouse

Denise a acheté ces chaussures mercredi

Denise a acheté ce chapeau Vendredi

Nxënësit mund t’i ndërrojnë rendin e rubrikave pa modifikuar numrin , psh

Monique l’a achetée hier

Monique n’a pas acheté cette blouse hier

f) Kështu pra, mund të dalin tipa të ndryshëm të transformuar.

Përparësi tjetër kryesore e metodës strukturale është se ajo mundëson, duke u nisur nga strukturat e prezentuara në formë zinxhirore të rubrikës dhe të një numri të kufizuar të elementeve që të prodhojnë një numër të madhë fjalësh analoge, që janë përvetsuar nga nxënësit në klasë, nën mbikqyrjen e mësimdhënësit.

Mund të dedikohet me formulimin e një serie të të njëjtës strukturë. P.sh.,

J’ai mal à la tête

J’ai mal au bras

J’ai mal au cœur

J’ai mal aux pieds

g) Përparësi e kësaj metode është se nxënësi praktikon një numër të madh përdorimesh të ndryshme të mekanizmit të tyre, d.m.th, lojën e strukturës (elementet e lakmueshme dhe të palakmueshme).

Mësimdhënësi nxënësve ua prezanton modelet për të cilat ata duhet :

- t’i marrin dhe t’i kuptojnë formulimet që përmbajnë struktura të reja,

- t’i riprodhojnë,

- t’i ndërtojnë duke filluar nga elementet që mund të shfrytëzohen.

Ky rikonstruktiv formulimesh të reja has në shkallë të ndryshme të vështirësive që nga nxënësi kërkon përpjekje, përqendrim dhe iniciativë. Metoda strukturale furnizon me një varg rubrikash, ku mund të zbatohen veprime të zëvendësimit dhe të transformimit që vë në dispozicion të mësimit të gjuhëve të huaja një metodologji gjerësisht të sprovuar në shumë vende.

Kjo metodologji mbështetet në parimin e ripërdorimit intensiv, në kontekste të ndryshme të strukturave për tu përvetsuar, derisa përdorimi i tyre duhet të automatizohet dhe të integrohet tek nxënësit.

Stërvitja merr formë ushtrimesh të ndryshme të njohura me emrin ushtrime strukturale, ku ekzistojnë të ndryshme strukturale, teknike dhe përdorimi i tyre.

Kështu, për ta pasqyruar passe compose -n e foljes aller, paraqesim formulime opozicioni. P.Sh.,

Aujourd'hui, j vais chez Denise,

Hier, je suis allé chez Gaston.

Shpjegimi i gramatikës

Njohuritë e një gjuhe në përvetsimin e një sjelljeje, gjithnjë ju kanë kundërvënë -në « Savoir theorique et savoir faire », duke pohuar se këto nuk paraqesin më një doracak teorik, se njeriu mund të mësojë vetë të notojë ose të vallëzojë, ose t'i hipë kalit, ose të drejtojë veturën ; është vërtetuar se t'i njohësh rregullat dhe të njohësh t'i zbatosh janë dy gjëra të ndryshme.

Sipas Emile Genouvrier dhe Glaudivine Gruvez, gramatika i ka dy objektiva : fundamentale dhe komplementare.

Zotërimi i praktikës (nivelet 1),

Zotërimin e kodit (nivelet 2).

Në fillim të nivelit të 1 gramatika duhet të integrohet në një mësim efektiv të gjuhës frënge, gramatika aty duhet të shërbejë po jo të sundojë. Në klasat e nxënësve të avancuar duhet t'i drejtohem përqendrimit të menduarit që shpie në përshkrimin e gjuhës. Emmanuel Wagner mbështet mendimin se : në nivelin elementar nuk bëhet fjalë për një refleksion në gramatikë, por ka të bëjë me nxerrjen, duke

filluar nga tekstet e përshtatura, të disa fakteve që do të automatizohen në saje të ushtrimeve. « Të shpjegosh një rregull, nukdo të thotë ta mësosh të përdorësh atë ».

Teksti duhet të furnizojë me modele që do të shërbenin si pikënisje për ushtrime. Falë të vërejturit me kujdes dhe të sistematizuarit e gjuhës në aspektin oral dhe në atë me shkrim, nxënësit, - të udhëhequr nga mësimit duke zbatuar me anë të metodës deduktive do t'i gjejnë, rregullat gramatikore, rregulla këto të normuara. Në këtë rast ndërhyhet vetëm sa për të vënë në pah. Në nivelin 1 gramatika mësohet drejtpërdrejt me anë të opozicionesh strukturale, e që bëjnë të kuptohet rregulla në mënyre induktive dhe mundëson të depërtohet në pikën e automatizimit.

Në këtë nivel mësimit duhet të jetë i vetëdijshëm për realitetet gramatikore, mbi cilat mbështetet, por jo edhe nxënësi. Fjala është, pra, për tremujorët e parë të NI (pjesa e parë) kurse në pjesën e dytë të vitit mësimor ushtrohen gamat, që më vonë te nxënësit do ta pasuronte të shprehurit në gjuhë të huaj.

Ushtrimi posaçërisht duhet të jetë i detyrueshëm, ashtu siç janë të detyrueshme ligjet që imponon gjuha. Kështu, si rezultat, del përfitimi i njohurive globale, jo të shpërndara të disa strukturave që i përgjigjen përdorimit në një situatë për ndonjë nevojë të shprehjes së posaçme.

P.sh

Qu'est-ce que c'est ?

Vous vous appelez-comment ?

Je m'appelle...,

Asseyez-vous,

Fermez (ouvrez) vos livres etc.

Gramatika strukturale ka gjetur zbatim në metodën audio-orale dhe në ato audio-vizuale.

Ajo që mund t'u zihet për të madhe këtyre metodave është mungesa e shpjegimit të strukturave në të mirë të manipulimit. Fjala është për mohimin e plotë të rolit të shprehurit në nxënjën e një gjuhe, por duhen evituar edhe teprimet, që mund të shpien në monotoni tek nxënësit duke i privuar nga faktori i motivimit.

Mund të konstatojmë dy objektiva të dallueshme : nivelin e manipulimit me elemente gjuhësore që u takojnë sistemeve të elementeve të definuara dhe nivelin e shprehjes personale në një situatë komunikimi. Në etapën e parë elementet gjuhësore përfitojnë në mënyrë induktive nëpërmjet ushtrimeve strukturale, me kohë duke dhënë edhe shpjegime nga mësimdhënësi .

Niveli i lartë i mësimi implikon zgjedhje të komplekseve që supozojnë njohje të sistemit gjuhësor më të ndërlikuar dhe më të thellë. Për të përparuar dy nivelet duhet të kombinohen.

Mësimi i gramatikës me anë të ushtrimeve strukturale duhet të gjejë vend me rëndësi në nivelin 1 (niveli i manipulimit), por nuk do të mjaftojë të siguroj shprehje spontane që është qëllim kryesor i mësimi të gjuhës së huaj.

Përpjekjet dhe veprimet që duhet të bëhen dhe metodat që duhet të përdoren në mësimdhënien e gramatikës.

Në nivelin 1, nga praktika e gjuhës nxënësit dinë një numër të madh strukturash, por dinë edhe për funksionimin e tyre. Në këtë nivel, tashmë të cekur, njohurit gramatikore fitohen në mënyrë implicite.

Por, megjithatë, pak a shumë nxënësitë e ndjejnë nevojën ta kuptojnë atë që mësojnë.

Refleksioni dhe shpjegimi bëhen të nevojshëm sepse u ndihmojnë nxënësve ta njohin funksionimin e strukturave, që kontribuojnë në kujtesën e tyre.

Me përpjekje induktive mësimdhënësi duhet t'i stimulojë nxënësit që ata vetë ta shpjegojnë këtë funksion.

Dukuria e re e gramatikës ilustron nëpërmjet një ballafaqimi të dy strukturave, njëra tashmë e njohur për nxënësit, ndërsa tjetra do të jetë objekt studimi.

Kundërshtimi duhet të evidencohet në një dialog të bërë nga mësimdhënësi, duke u mbështetur në situata të inspiruara nga teksti i mësimi. Ja një shembull që ilustron prezantimin e përemrit ndajfoljor 'En' në klasat V dhe VI –të shkollës fillore.

Modeli : Elle mange des pommes ?

Oui, elle en mange.

Pra, prezantimi, i modeli lidhet me pjesën e parë të të kuptuarit ndaj një qasjeje të re të gramatikës. Duke filluar nga modeli mësimdhënësi e fillon dialogun:

Qu'est –ce qu'elle mange?

Elle mange des pommes.

Elle en mange.

Est-ce que tu manges des pommes?

Est-ce que tu en manges?

Oui, Je mange des pommes

Elle en mange

Et, toi, Drita, Est- ce que tu en mange?

Oui, j'en mange aussi?

Pas këtij dialogu të shpejtë, mësimdhënësi shkruan në tabel opozicionin dhe kështu i shtynë nxënësit ta vrenjë dhe të mendojnë për të.

Ai kërkon që nxënësit ta vështrojnë me vëmendje zëvendësimin e bërë në formulimin e dytë, vendi që zë përemri ndajfoljor 'En'.

Kur vështrojnë me kujdes, nxënësit arrijnë ta përvetësojnë funksionin e këtij opozicioni .

Përfitimi i njohurive të reja do të ngulitet me ushtrime strukturale të zëvendësimit dhe transformimit:

a) Ushtrime zëvendësimi (Exercices de substitution)

Modeli 1.

Est-ce qu'elle achète des fleurs?

Oui, elle en achète.

Shembulli: des livres, des fruits, du pain, du chocolat, de la viande, de l'huile, des bombons etc.

Ky ushtrim do të bëjë të kuptohet, në të njëjtën kohë, se 'En' zëvendëson emrat që kanë përpara nyjen pjesore. P.sh.,

Modeli: Est-ce qu'elle a acheté beaucoup de fleurs?

a) Oui, elle en a acheté beaucoup.

Stimuli 'assez',

'Peu'

'une grande quantité'

'un paquet'.

b) Ky ushtrim është i destinuar për të saktësuar përdorimin 'en'-it në formulime që përfshijnë një ndajfolje sasi ose një togfjalësh, që shprehin sasi. Në gjuhën shqipe 'en' nuk ekziston, kështu

që ky përemër ndajfoljor në fillim të nxënësit shqiptarë krijon vështirësi për ta kuptuar funksionin e tij në fjali.

Modeli:

Est-ce qu'il boit de l'eau?

Non, il n'en boit pas.

Stimuli

De la bière

Du vin

Du lait

De l'orangeade etc.

Ndër metodat më të rëndësishme që përdoren në mësimdhënien e gramatikës janë bashkëbisedimi dhe ushtrimi.

Bashkëbisedimi është njëri ndër strategjitë metodologjike më kryesore. Ai shërben për të futur struktura të reja, për t'i udhëzuar nxënësit lidhur me përgjithësimet, se si bëhen ato ripërdorime. Kjo bëhet në mënyrë që dialogu i dirigjuar të shfrytëzohet për krijimin e automatizmave të nxënësit.

Shembulli:

1. C'est le livre de Jean?

Oui, c'est le livre de Jean.

C'est son livre?

Oui, c'est son livre.

Mikrokonveracioni është i mjet i shkëlqyeshëm për të integruar strukturat gramatikore të shprehurit.

Konkluzion:

Në fund mund të konkludojmë se metoda strukturale insiston në të mësuarit e gjuhës së

huaj, që të komunikohet në situata të jetës së përditshme.

Ajo mbështetet në gramatika implicite me ushtrime të përmbledhjes së strukturave në situata të zëvendësuara. Në këtë metodë përparësi i jepet gjuhës së dytë, ndërsa mësimdhënësi shndërohet në teknik të metodës.

Ajo është metodë e cila në mënyrë teje të hollësishme informon nxënësit për të gjitha problemet teorikedhe praktike që ata hasin gjatë mesimit të gjuhës së huaj.

Ajo ofron njohuri të gjithanshme, por nuk lehtëson përdorimin e gjuhës së huaj gjatë bashkëbisedimit sikur metoda direkte.

### **Bibliografia**

B. Pottier, A propos des structures grammaticales, në Le Français dans le Monde, No.32/1965, fq.10.

C. Rojas, Colette, L'enseignement de la Grammaire, në Le Français dans le Monde, No 65/1969.

Chevalier. C. L., Quelle grammaire enseigner ? Në Le Français dans le Monde. no. 55/1968, fq.7.

E E.Roulet, vep. cit., fq. 34.

Guenot, J., Clefs pour les langues vivantes, Paris, Seghers, 1964, fq.4.

Genouvrier. E Gruwez CCI. Français et exercices structuraux C.M.2 Vep. e cituar.

Hajdari, Ahmet . Tekste shkollore, kl Vdhe VI të gjuhës frënge, Shkup, 1974.

Wagner Emmanuel, Voix et images de France, Didier, 1961, fq.9, 10.